




UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“LUIGJ GURAKUQI”

Nr. 186 Prot.

Nr. 780 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, përfaqësuar nga rektori Prof. Dr. Andrea MALIQARI dhe;

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”, përfaqësuar nga rektori Prof. Dr. Adem BEKTESHI,

Me qëllim vendosjen dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi në interes të dyanshëm.

Neni 1

Fushat e bashkëpunimit

Marrëveshja synon të vendos dhe të thellojë bashkëpunimin midis UPT dhe UNISHK në fushat dhe drejtimet e mëposhtme:

- Hapja e një shkolle të përbashkët doktrature, në të cilën UPT do të ketë kuota të veçanta për studentët e saj;
- Shkëmbimin e personelit akademik për dhënie leksionesh të veçanta në lëndët apo modulet që ato i gjykojnë me interes, sipas kushteve dhe mundësive;
- Shkëmbimin e studentëve sipas kushteve dhe mundësive;
- Shkëmbimin e botimeve akademike apo periodike;

- Ndhimën reciproke në kualifikimet e personelit akademik, nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese apo udhëheqjes shkencore për përgatitje dhe mbrojtje mikrotezash;
- Pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të përbashkëta studimore;
- Pjesëmarrjen e personelit akademik në projekte të përbashkëta kërkimore dhe shkencore;
- Informimin reciprok për organizimin e konferencave shkencore nga ana palëve ose në bashkëpunim me fakultete apo institucione homologe, vendase ose të huaja si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së personelit akademik në këto veprimtari;
- Krijimin e mundësive dhe hapësirave për botime shkencore në revistat e institucioneve nga personeli akademik;
- Dërgimin e programeve dhe planeve të tyre mësimore për studimet në fushat me interes të përbashkët;
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët, sipas kushteve dhe mundësive;
- Krijimin e mundësive për përdorimin reciprok të bibliotekave për literaturë të paklasifikuar për personelin akademik dhe studentit e UPT dhe UMSH, si dhe inkurajimin e përdorimit të teksteve mësimore në mënyrë të ndërsjelltë.

Neni 2

Detyrimet e palëve

Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, marrin përsipër përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, në respektim të ligjeve dhe strategjive të zhvillimit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Afati i marrëveshjes

- Marrëveshja lidhet për një afat kohor prej 5 (pesë) vitesh.
- Afati i marrëveshjes fillon nga data e nënshkrimit të saj nga titullarët e të dyja institucioneve.

Neni 5

Amendimet e marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet pjesërisht ose tërësisht nëse për këtë palët bien dakord më parë midis tyre.

Neni 6

Përfundimi i marrëveshjes

- Palët kanë të drejtë që me marrëveshje me shkrim midis tyre, të zgjidhin marrëveshjen përpara plotësimit të afatit të saj.
- Në rast se njëra nga palët kërkon të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, ajo duhet të njoftojë me shkrim brenda 3 (tre) muajve palën tjetër, në mënyrë që të mundësohet përfundimi i aktiviteteve në proces.

Neni 7


Dispozita të fundit

- Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje me të njëjtën vlerë juridike.
- Palët angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.
- Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua sot, me datë 21/02/2020, dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Universiteti Politeknik i Tiranës

REKTORI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



Universiteti i Shkodrës

“Luigj Gurakuqi”

REKTORI

Prof.dr.Adem BEKTESHI

